



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 121, Datë 04.04.2023

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË”
(FTL) SH.A., NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 4 pika 1, gërma “e”, 5 pika 1 gërma “e” dhe 10 pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.04.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1000/3 prot., datë 31.03.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqytjes, “Mbi rinovimin e licencës të shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL) sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 199, datë 03.09.2018”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 76, datë 15.03.2023, vendosi fillimin e procedurës së rinovimit të licencës dhënë shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 199, datë 03.09.2018.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.03.2023 dhe 17.03.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 25.03.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores dhe po ashtu ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Në zbatim të përcaktimeve të Rregullores, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur). Nga aplikimi rezulton se shoqëria “FTL” sh.a. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin sa kërkuar për aplikim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë e licencën Nr. 423, Seria F18, të shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL) sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, , për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 04.09.2023.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI

Petrit AHMETI